

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA NGA PLANI OPERATIV PËR PUNËSIM PËR VITIN 2019!



Социјална
отчетност за
**РОДОВА
ЕДНАКВОСТ**



I. MBËSHTETJE PËR VETË-PUNËSIM (SIPËRMARRJE)

ÇFARË MUNDËSON MASA “MBËSHTETJE PËR VETË-PUNËSIM?”

Kjo masë mundëson që personat e papunë të regjistrojnë subjekt juridik dhe të vetë-punësohen. Me këtë, nëse themelohet subjekt juridik me një person (SHPKNJP) masa ju siguron ndihmë në shumë prej 246.000 denarë, ndërsa nëse themelohet subjekt ligjor me dy partnerë (SHPK) masa ju siguron ndihmë në shumë prej 615.000 denarë.

Me këtë masë mund të themelohen lloje të ndryshme të bizneseve, përfshirë edhe prodhimtari organike bujqësore, përveç:

- prodhimtari bimore dhe blegtores, gjueti dhe veprimtari shërbimi lidhur me ato,
- shërbim taksi,
- prodhimtari dhe shpërndarje të armëve,
- prodhimtari të armëve dhe municionit,
- biznese financiare dhe të sigurimit dhe aktivitete që përfshijnë lojëra të fatit.

Për zbatimin e kësaj mase Agjencia ka siguruar 362 milionë denarë për 1.070 persona të papunë.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR MASËN “MBËSHTETJE PËR VETË-PUNËSIM?”

Të drejtë përdorimi të kësaj mase kanë të gjithë personat e papunë që janë të regjistruar në evidencën e të papunëve të Agjencisë për Punësim, pavarësisht se për çfarë periudhe janë të regjistruar.

Gjatë përzgjedhjes së pjesëmarrësve, përparësi jepet për:

- persona të papunë të rinj deri më moshën 29 vjeç,
- persona të papunë me aftësi të kufizuara,
- gra të papunë marrës të ndihmës sociale,
- viktima të dhunës familjare,
- viktima të trafikimit me qenie njerëzore,
- gra të papunë në afat të gjatë,
- nënë të vetme me fëmijë,
- gra të përjashtuar social në bazë të tepricës teknologjike dhe falimentimit, dhe
- persona të papunë që kanë përfunduar trajnim për sipërmarrje dhe/ose kanë hartuar plan afarist në kuadër të planit operativ për vitin 2018.



NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI MASËN “MBËSHTETJE PËR VETË-PUNËSIM?”

Personat e papunë mund të përfshihen në masën vetëm me anë të parashtrimit të kërkesës (pyetësor për vlerësim të shkathtësive sipërmarrëse) në zyrat rajonale të Agjencisë së Punësimit, pasi që Agjencia të ketë publikuar thirrje publike për aplikim në:

- internet faqen zyrtare të Agjencisë, që mund të gjendet në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/oglasia-za-aktivni-merki.nspx>;
- Facebook faqen zyrtare të Agjencisë, që mund të gjendet në lidhjen më poshtë: <https://www.facebook.com/avrmakedonija>;
- tabelës për shpallje në zyrën rajonale të Agjencisë në të cilën jeni regjistruar si person i papunë;
- internet faqen zyrtare të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, që mund të gjendet në lidhjen vijuese: <http://www.mtsp.gov.mk/oglasia-izvestuvanja.nspx>;

CILI PERSON NGA ZYRA RAJONALE E AGJENCISË SË PUNËSIMIT NË TË CILËN JENI REGJISTRUAR SI PERSON I PAPUNË ËSHTË PËRGJEGJËS DHE MUND TË NDIHMOJË QË TË PËRFSHIHENI NË KËTË MASË?

Për të qenë të përfshirë në këtë masë kërkonte personat nga zyra rajonale të Agjencisë për Punësim në të cilën jeni regjistruar si person i papunë që janë në pozitat e udhëheqësve ose këshilltarë për masa aktive të punësimit. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

Për më tepër informacione mbi procedurën e parashtrimit të kërkesës shikoni dokumentin të dhënë bashkë me këtë material informativ.



II. SUBVENCIONIMI I RROGAVE

ÇFARË MUNDËSON MASA “SUBVENCIONIMI I RROGAVE?”

Kjo masë mundëson punësimin e personave të papunë që më vështirë kyçen në tregun e punës, me anë të sigurimit të mbështetjes financiare, në shumë prej 19.000 denarë për çdo muaj, për kompanitë që do të punësojnë këto persona në periudhë prej 3, 6 dhe 12 muaj dhe të mbajë personin në punë prej 9 deri 30 muaj varësisht nga lloji i mbështetjes së përdoruar.

Për zbatimin e kësaj mase Agjencia ka siguruar 228 milionë denarë për 1.000 persona të papunë.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR MASËN “SUBVENCIONIM I RROGAVE”?

Mbështetjen financiare mund të fitojnë format mikro, të vogla dhe të mesme; ndërmarrjet sociale dhe organizatat qytetare (joprofitabile) që merren me aktivitet ekonomik gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre; si dhe ndërmarrje të reja të themeluar me anët e masës për vetë-punësim në vitin 2019.

Nga ana tjetër, kjo masë është e synuar për punësim të:

- personat e papunë që janë të evidentuar si të papunë për më tepër se 12 muaj, me përparësi të personave që janë të papunë mbi 5 vite;
- persona të papunë të rinj deri më moshën 29 vjeç
- persona të papunë më të moshuar se 50 vjeç
- persona të papunë përdorues të ndihmës së garantuar minimale ose të kompensimit në holla në bazë të papunësisë
- persona të papunë që kanë qenë përdorues të Programit për Kompensim të Kushtëzuar në të Holla për Arsimin e Mesëm
- persona të papunë që kanë pasur status të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror
- viktima të dhunës familjare
- persona të papunë me aftësi të kufizuar
- gratë të përkatësisë së komunitetit etnik rom dhe komuniteteve tjera etnike
- persona të papunë të përkatësisë së komunitetit etnik rom
- prindër të vetëm me fëmijë
- prindër me fëmijë që janë me aftësi të kufizuar
- prindër të 3 ose më tepër fëmijëve
- prindër të fëmijëve në rrugë
- persona të dënuar pas liritimit nga institucionit ndëshkues
- persona pa strehim
- ish përdorues të drogës
- persona me arsim të pakompletuar të mesëm ose më të ultë



NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI MASËN “SUBVENCIONIM I RROGAVE?”

Personat e papunë mund të kyçen në masën vetëm nëse ndonjë kompani që ka nevojë që personi i ri të parashtrojë fletëparaqitje për pjesëmarrje dhe kërkesë për ndërmjetësim gjatë punësimit. Fletëparaqitja dhe kërkesa parashtrohen tek zyrat rajonale të Agjencisë së Punësimit, pasi që Agjencia të ketë publikuar thirrje publike për aplikim në:

- internet faqen zyrtare të Agjencisë, që mund të gjendet në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/oglasia-za-aktivni-merki.nspk>;
- Facebook faqen zyrtare të Agjencisë, që mund të gjendet në lidhjen më poshtë: <https://www.facebook.com/avrmakedonija>;
- tabelës për shpallje në zyrën rajonale të Agjencisë në të cilën jeni regjistruar si person i papunë;
- internet faqen zyrtare të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, që mund të gjendet në lidhjen vijuese: <http://www.mtsp.gov.mk/oglasia-izvestuvanja.nspk>;

CILI PERSON NGA ZYRA RAJONALE E AGJENCISË SË PUNËSIMIT NË TË CILËN JENI REGJISTRUAR SI PERSON I PAPUNË ËSHTË PËRGJEGJËS DHE MUND TË NDIHMOJË QË TË PËRFSHIHENI NË KËTË MASË?

Për të qenë të përfshirë në këtë masë kërkon personat nga zyra rajonale të Agjencisë për Punësim në të cilën jeni regjistruar si person i papunë që janë në pozitat e udhëheqësve ose këshilltarë për masa aktive të punësimit. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

Për më tepër informacione mbi procedurën e parashtrimt të kërkesës shikoni dokumentin të dhënë bashkë me këtë material informativ.



III. SHËRBIME PËR PUNËSIM

III.1. NDIHMË GJATË KËRKIMIT TË PUNËS

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “NDIHMË GJATË KËRKIMIT TË PUNËS?”

Shërbimi “Ndihmë gjatë kërkimit të punës” mundëson:

- përgatitje të Planit Individual për Punësim,
- këshillim për punësim,
- sigurim të informacioneve për vende të lira të punës,
- informim për programet aktuale aktive dhe masat për punësim dhe shërbimet,
- ndihmë gjatë përpilimit të CV-së dhe letrës së motivacionit,
- përforcimi i shkathtësive për prezantim të suksesshëm para punëdhënësve gjatë intervistës për punë,
- edukim mbi përdorimin e shërbimeve on-line të Agjencisë së Punësimit,
- organizimi i takimeve informative për të rinjtë dhe personat tjerë të papunë.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “NDIHMË GJATË KËRKIMIT TË PUNËS?”

Të gjithë personat e papunë që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “NDIHMË GJATË KËRKIMIT TË PUNËS?”

Personat e papunë mund të përdorin shërbimin me anë të caktimit të takimit me ndonjë prej bashkëpunëtorëve për shërbime të mbështetjes për punësim që janë të punësuar në zyrën rajonale të Agjencisë. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

III.2. TRAJNIME MOTIVACIONI

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “TRAJNIME MOTIVACIONI?”

Shërbimi mundëson pjesëmarrje të trajnimeve njëditore në grupe ose takime individuale me këshilltarë të mbështetjes për punësim në të cilat personat e papunë informohen për mundësitë për punësim dhe i motivojnë personat e papunë të kyçen në masat aktive dhe programet për punësim dhe kërkim të punës.



KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “TRAJNIME MOTIVACIONI?”

Të gjithë personat e papunë që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “TRAJNIME MOTIVACIONI?”

Personat e papunë mund të marrin pjesë në trajnime motivacioni me anë të paraqitjes së interesit tek këshilltarët të shërbimeve për mbështetje të punësimit që janë të punësuar në zyrën rajonale të Agjencisë. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

III.3.

TRAJNIMI “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË”

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË?”

Shërbimi mundëson pjesëmarrje në trajnime shumëditore në të cilat personat e papunë vijojnë trajnim për zhvillim personal, shkathtësi për kërkim të punës, shkathtësi komunikimi, sjellja e drejtë në vendin e punës, puna në ekip dhe udhëheqje, siguri, të drejt dhe obligime të punës dhe shkathtësi financiare.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË?”

Të gjithë personat e papunë të rinj deri më 29 vjeç që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË?”

Personat e papunë mund të marrin pjesë në trajnime për punësim dhe për punë me anë të paraqitjes së interesit tek këshilltarët të shërbimeve për mbështetje të punësimit që janë të punësuar në zyrën rajonale të Agjencisë. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;



III.4.

ORIENTIMI PROFESIONAL DHE KËSHILLIMI PËR KARRIERË

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “ORIENTIMI PROFESIONAL DHE KËSHILLIMI PËR KARRIERË?”

Shërbimi mundëson që personat e papunë të zhvillojnë shkathtësi për kërkim të punës dhe planifikim dhe menaxhim me zhvillimin personal të karrierës, ndihmë gjatë zgjedhjes së okupacionit, trajnimit ose punësimit, si dhe mbështetje plotësuese gjatë vlerësimit të potencialeve personale për punësim dhe përputhja e tyre me nevojat e vërteta të tregut të punës.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË?”

Të gjithë personat e papunë që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “PËRGATITJE PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË?”

Personat e papunë mund të përdorin shërbimin me anë të paraqitjes së interesit tek ndonjë prej bashkëpunëtorëve për shërbime të mbështetjes për punësim që janë të punësuar në zyrën rajonale të Agjencisë. Detajet e tyre për kontakt mund të gjeni në lidhjen më poshtë: <http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

III.5.

AKTIVIZIM I ROMËVE TË PAPUNË

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “AKTIVIZIMI I ROMËVE TË PAPUNË?”

Shërbimi mundëson motivim dhe informim i rregullt të qytetarëve të komunitetit rom mbi mundësitë e punësimit ose përmirësimit të kapaciteteve të tyre profesionale, si dhe identifikimit të njohurive, kualifikimeve dhe shkathtësive me të cilat disponojnë këto qytetarë dhe orientimi i tyre për programet përkatëse aktive dhe masat për punësim dhe shërbime për punësim.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “AKTIVIZIMI I ROMËVE TË PAPUNË?”

Të gjithë personat e papunë komunitetit etnik rom që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit.



NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “AKTIVIZIMI I ROMËVE TË PAPUNË?”

Personat e papunë mund të përdorin shërbimin në mjedisin e tyre të vendbanimit, në mënyrë që mentorë të angazhuar nga ana e Agjencisë duhet të vizitojnë shtëpitë e tyre.

III.6. NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT?”

Shërbimi mundëson këshillim dhe ndihmë për punëdhënësit me anë të kërkimit të kandidatëve për vendet e lira të punës nga evidenca e personave të papunë të Agjencisë, zbatimi i para-zgjedhjes, referimi i personave të papunë tek punëdhënësit për intervistë për punësim, etj.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT?”

Të gjithë punëdhënësit që kanë nevojë për të punësuar të rinj.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT?”

Personat e papunë mund të përdorin shërbimin vetëm nëse Agjencia i për zgjedh si persona që kanë kualifikime që përputhen nevojave të punëdhënësit.

III.7. SHËRBIME PËR PUNËDHËNËS

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “SHËRBIME PËR PUNËDHËNËS?”

Shërbimi mundëson informim, këshillim dhe sigurim të mundësive për përdorim të shërbimeve dhe programeve aktive dhe masave për punësim dhe mundësi tjera të punësimit të personave të papunë, edukim për përdorim të veglave on-line të Agjencisë së Punësimit, informacione dhe këshillime nga fusha e të drejtës së punës, pjesëmarrje në ngjarje të përbashkëta siç janë forumet për punëdhënësit, etj.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT?”

Të gjithë punëdhënësit.



NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT?”

Ky shërbim është tërësisht e synuar për punëdhënës dhe persona të papunë që nuk janë përdorues të drejtpërdrejtë të këtij shërbimi.

III.8.

ANKETA PËR NEVOJA TË SHKATHTËSIVE NË TREGUN E PUNËS

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “ANKETA PËR NEVOJA TË SHKATHTËSIVE NË TREGUN E PUNËS?”

Shërbimi parashikon anketim të punëdhënësve nga sektori privat, me qëllim të grumbullimit të informacioneve për nevojat e tyre për punësime të reja në periudhë prej 6 deri 12 muaj.

KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “ANKETA PËR NEVOJA TË SHKATHTËSIVE NË TREGUN E PUNËS?”

Të gjithë punëdhënësit dhe 20 perona të papunë nga evidenca e Agjencisë së Punësimit.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “ANKETA PËR NEVOJA TË SHKATHTËSIVE NË TREGUN E PUNËS?”

Ky shërbim është tërësisht i synuar për punëdhënës dhe vetëm 20 perona të papunë që janë të regjistruar në evidencën e Agjencisë së Punësimit kanë mundësi, në bazë të angazhimit të përkohshëm, të përfshihen në zbatimin e anketës për nevojat e tregut të punës. Personat e papunë nuk kanë mundësi të aplikojnë për pjesëmarrje, por identifikimin e anketuesve e bënë vetë Agjencia nga baza e të papunësuarve të regjistruar.

III.9.

SIM - KËSHILLIM DHE MOTIVIM PËR PËRDORUES TË NDIHMËS MINIMALE TË GARANTUAR

ÇFARË MUNDËSON SHËRBIMI “SIM - KËSHILLIM DHE MOTIVIM PËR PËRDORUES TË NDIHMËS MINIMALE TË GARANTUAR?”

Ky shërbim ju mundëson personave të papunë që përdorin ndihmë minimale të garantuar të fitojnë mbështetje intensive psikologjike-sociale para se të përfshihen në ndonjë masë aktive për punësim dhe mbështetje me mentor gjatë përfshirjes në ndonjë prej masave aktive dhe gjatë themelimit të marrëdhënieve të punës.



KUSH KA TË DREJTË TË PËRDOR SHËRBIMIN “SIM - KËSHILLIM DHE MOTIVIM PËR PËRDORUES TË NDIHMËS MINIMALE TË GARANTUAR?”

Persona të papunë nga evidenca e Agjencisë së Punësimit që përdorin ndihmë minimale të garantuar.

NË ÇFARË MËNYRE MUND TË PËRDORNI SHËRBIMIN “SIM - KËSHILLIM DHE MOTIVIM PËR PËRDORUES TË NDIHMËS MINIMALE TË GARANTUAR?”

Bashkëpunëtorët për shërbime të mbështetjes për punësim duhet individualisht të ftojnë gjithë personat e papunë që përdorin ndihmë minimale të garantuar dhe të përfshijnë ata në këtë shërbim. Ose, nëse, personi përgjegjës nuk ju fton, ju keni të drejtë të kërkonti përfshirjen tuaj me anë të kontaktimit të këshilltarëve përgjegjës në zyrën më të afërt të agjencisë në telefonat e dhënë në lidhjen më poshtë:
<http://av.gov.mk/content/Инфо/наде.pdf>;

Për më tepër informacione mbi procedurën e parashtrimit të kërkesës shikoni dokumentin të dhënë bashkë me këtë material informativ.